



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Në ankesën e

AC-I-22-0600-A0001

Paditësi/Ankuesi

F B, Prishtinë.- i përfaqësuar nga avokati E H.

kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-II-20-0002-C0001 të datës 06 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë C-II.-20-0002-C0001 të datës 06 shtator 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 29 janar 2020, paditësi parashtroi një kërkesë/ankesë në DHPGJS dhe kërkoj që atij ti njihen benificionet nga NSH IGK Ballakn" Suharekë, për periudhën kohore nga 20 shtator 1979 deri me 24 shtator 1990, meqë ishte punëtor i NSH-së në sektorin e shkrirjes së Gomës. Ka shtuara se mbas privatizimit të ndërmarrjes të gjithë punëtorët kanë marrë beneficione në shumën që ju ka takuar ndërsa atij nuk i janë dhen benificionet e të cilat i takojnë si punëtor i NSH-së. Dukë qenë në listën e punëtoreve, ai nuk ka pranuar asnjë benefit. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar Vendimin nr.872 i datës 20 gusht 2001 për njohjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës për periudhën 08 gusht 1990 deri me 01 korrik 1999, lista e punëtoreve të cilët kanë marrë 20% dhe Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.176/05 të datës 24 qershor 2005.

Me 20 shkurt 2020, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS një përgjigje dhe ka deklaruar se në bazë të nenit 10.6 të rregullores 2003/13 "Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media.". Afati për parashtrimin e ankesës në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare ishte data 26 tetor 2013, ndërsa ankuesi ka parashtruar ankesën më 29 janar 2022. Mbrojtja po ashtu ka shtuar se bazuar në nenin 130.3 të ligjit të procedurës kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme. Andaj i ka propozuar Gjykatës që ankesën e ankuesit ta hedhë poshtë si të pa pranueshme.

Më 05 mars 2020, paditësi përmes një urgjence njoftoi DHPGJS se Agjencia Kosovare e Privatizimit i ka paguar shumën prej 20% nga privatizimi i Ndërmarrjes NSH "IGK Ballkani", ndërsa kërkoi nga gjykata ti njoh borxhin e pa paguar sipas vendimit të NSH Ballkani nr.872, të datës 20 gusht 2001 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë të datës 24 qershor 2005. Parashtrësë i ka bashkangjitur një vendim të Autoritetet të Likuidimit (AL) PRZ014-0042/1158 (në emër të një personi tjetër fizik) si dhe provat tjera të cilat i ka dorëzuar si në ankesë.

Me 11 janar 2021, Shkalla e I-rë DHPGJS, përmes urdhrimit kërkoj nga paditësi të bëjë precizimin e ankesës dhe të dorëzoj vendimin e AL nëse ai ka parashtruar kërkesë në AL, si dhe të saktësoj periudhën kohorë dhe lartësinë e pagave për të cilat ai pretendon.

Me 25 shkurt 2021, paditësi me një parashtresë të titulluar si urgjencë ka kërkuar përsëri nga DHPGJS, kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën prej 8 gusht 1990 e deri më 1 korrik 1999 në shumën prej 5,327.56 euro. Ka theksuar se atij nuk i është lëshuar ndonjë vendim nga ana e AKP-së, prandaj ka kërkuar nga gjykata që të marr vendim për njohjen e këtyre pagave në shumën e lartcekur.

Më 14 maj 2021, AKP-ja ka paraqitur mbrojtjen në ankesën e paditësit duke e konsideruar si të pa pranueshme dhe të pa objekt, për faktin se duhet të ekzistojë një vendim i Autoritetit të Likuidimit ndaj të cilit mund të paraqitet padia apo ankesa. Sipas të paditurës, paditësi nuk ka paraqitur ankesë kreditore për të cilën do të ishte dashtë të vendosej, pra nuk ka vendim të AL-së ndaj të cilit do të duhej të ishte drejtuar ankesa. Po ashtu ka shtuar se paditësi nuk ka prezantuar fakte në kuptim të nenit 7 të Ligjit të Procedurës kontestimore.

Me 06 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktvendimin C-II-20-002-C0001, e hedhë poshtë si të pa pranueshme, ankesa kundër Vendimit të Autoritetit të likuidimit të AKP-së.

Në arsyetim të këtij aktvendimi thuhet se duke u bazuar në nenin 74.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se: Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendim i autoritetit të likuidimit mund të kundërshtojë vendimin e tillë duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë brenda 30 ditëve pas pranimit të vendimit. Ankesa duhet të jete në pajtim me kërkesat e paragrafit 2. të nenit 27 të kësaj shtojce dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi.

Nenet 33 dhe 35, të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ndër të tjera rregullojnë parashtrimin e kërkesave përkatësisht ankesave dhe nisja e procedurave në Dhomën e Posaçme. Neni 35.2 më tej përcakton se çfarë duhet të përmbajë një kërkesë apo ankesë. Tutje Shkalla e I-rë ka arsyetuar se duke u bazuar në shtojcën e ligjit NR.04/L033 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përkatësisht në nenin 25,27,28 dhe 70.2 të njëjtit, si ligj i cili ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimit të ankesës. Andaj , në kuptim të këtyre dispozitave gjykata vjen në përfundim se ankesa duhet të dorëzohet në gjykate së bashku me vendimin e atakuar të Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit 30 ditor pas pranimin të vendimit. Në këtë mënyrë, dorëzimi i vendimit të atakuar nga ankuesi është një kriter i provueshmërisë së ankesës, përkatësisht mosdorëzimi i këtij vendimi nga vet ankuesi, e bën ankesën e tij të pa pranueshme. Së ankesës përkatësisht mos dorëzimi i këtij vendimi nga vet ankuesi, e bën ankesën e tij të pa pranueshme.

Gjithashtu Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësit i kishte ofruar edhe një mundësi ankuesit për të plotësuar këtë kusht të pranueshmërisë ashtu që nëpërmjet urdhrin të saj të datës 11 janar 2021, i kërkoi dorëzimin e vendimit të atakuar të Autoritetit likuidimit, brenda afatit të përcaktuar në atë urdhër kjo për faktin se ankesa e ankuesit në fillimi kishte për objekt futjen në listën përfundimtare për të qenë pjesë e shpërndarjes së 20% me rastin e privatizimit të NSH-së. Ndërsa, më vonë njofton gjykatën për përfitimin e 20%-shit dhe në të njëjtën parashtrësë paraqet kërkesën e tij për paga të pa paguara.

Shkalla e I-rë ka ardhë në përfundim se meqenëse ankuesi dështoi në përmbushjen e kërkesës sipas urdhrin të gjykatës për të dorëzuar kopjen e Vendimit të kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit, gjykata vendosi të hedhë poshtë ankesën e tij si të pa pranueshme duke u bazuar në nenet 36.1, 36.3 dhe 74.2 të Ligjit për dhomën e Posaçme.

Me 28 tetor 2022, paditësi nëpërmjet përfaqësuesit ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-II-20-0002-C0001 të datës 06 shtator 2022. Paditësi me ankese kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të anulohet Aktvendimi i atakuar dhe të obligohet e paditura t'ia paguaj paditësit borxhin për pagat e pa

paguara për periudhën kohore 8 gusht 1990 -1 korrik 1999, në shumën prej 5,327.56 euro, si dhe të obligohet e paditura që të paguajë shpenzimet procedurale. Ankuesi në ankesën e parashtruar e ka kundërshtuar aktvendimin e shkallës së I-re për shkak se sipas tij, siç ka arsyetuar Shkalla e I-re ka paditësi ka dështuar në përmbushjen e kërkesës sipas urdhrit të Gjykatës, për të dorëzuar kopjen e Vendimit të kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit. Gjykata i referohet neneve 74.2,36.2.2.5 dhe 36.2.2.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme duke elaboruar se kërkesa apo ankesë është e pranueshme nëse kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 të kësaj shtojce dhe është në përputhje me dispozitat e nenit 35 të Ligjit.

Në lidhje me këtë , ankesa në fjalë parashtrohet duke u bazuar në aktgjykimin në bazë të pohimit,C.nr176/05, të datës 24 qershor 2005, me të cilën është aprovuar padia kërkesëpafia e punëtoreve të NSH IGK "Ballakni" në Suharekë si dhe në Vendimin mbi Njohjen e të Drejtave nga Marrëdhënia e Punës për Periudhën 8 gusht 1990- 1 korrik 1999, të datës 17.08.2001, me të cilin ankuesit i janë njohura të drejtat nga marrëdhënia e punës për periudhën e aplikimit të masave të dhunshme të periudhës së lartcekur. Ka shtuar se paditësi në rastin konkret nuk ka paraqitur ankesë kundër vendimit të AL, por ka pasur për qëllim të praqes ankesë për kompensimin e të ardhurave të garantuara për periudhën nga 08 gusht 1990 deri më 1 korrik 1990, në vlerë 5,327.56 euro, të përcaktuar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.176/05 të datës 24 qershor 2005. Po ashtu ankuesi konsideron se Gjykata në rastin konkret ka bërë shkelje të ligjit material duke dështuar të njoftojë palën ankuese me dispozitat e nenit 32 paragrafi1 dhe 3, një njoftim i cili është në përputhje me paragrafin 5 të nenit 32 dhe i cili thekson se :“ Dhoma e Posaçme menjëherë njofton palën e cila nuk përfaqësohet nga avokati për dispozitat e këtij neni .” Ka shtuar se paditësi ankesën e tij e ka parashtruar individualisht, pa ndihmën e një profesionisti të fushës, gjithmonë pa pranimin e informatës së legjisllacionit në fuqi e obligon njoftimin e tij për angazhimin e një avokati, qoftë të Odës së Avokatëve sipas detyrës zyrtare, apo sipas Ligjit për Ndihme Juridike falas. Ankuesi laik, ka pretenduar në kërkesën e tij legjitime, pa pasur njohuri të drejtësisë si dhe në interes të palës. Vetëm në ditët e fundit, ankuesi me vete-iniciativë ka angazhuar përfaqësuesin sipas autorizimit.

Tutje ka shtuara se në vitin 2014, paditësi nuk është njoftuar nga AKP, për mundësinë e ekzekutimit të Aktgjykimit të vitit 2005, si dhe njëkohësisht i njëjti nuk ka pasur qasje në media, gazeta apo media sociale në të cilat ka mundur të publikohet njoftimi për kompensim për shkak të likuidimit të NSH Ballkani gjithë kolegët, punëtorët të NSH Ballkani, të cilët ishin në listën e përfitueseve kanë pranuar kompensimin nga AKP, këto të dokumentuara edhe me prova të caktuara të cilat për momentin konsiderohen se mund të dëmtojnë palët tjera të interesit dhe për këtë arsye nuk iu kanë bashkangjitur kësaj ankese. Mirëpo të njëjtat mund të dorëzohen në rast të kërkesës nga Kolegji i Apelit dhe në përputhje me nenin 33 paragrafi 7 të Ligjit. Edhe pse punëtorët tjerë janë kompensuar, e njëjta gjë nuk ka ndodhur për paditësin, edhe pse i njëjti paraqitet edhe në Listën përfundimtare të cilat i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të hyrave, sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 9 me ndryshime), të N.SH Ballkani Suharekë-FI575/89.

Në ankesën e parashtruar paditësi thekson se Agjencia Kosovare e Privatizimit ka dështuar të respektojë nenin 7, paragrafin 2, nën paragrafi 2.6 të shtojcës së Ligjit nr.04/I-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit duke mos përfshirë deklaratën e theksuar në nën paragrafin 2.6.4 i cili thotë: " Njoftimin që përfshin një deklaratë të qartë me shkronja të theksuara se të gjitha kërkesat dhe Interesat që nuk janë parashtruar si duhet deri në Afatin për parashtrimin e kërkesave do të refuzohen dhe do të jenë përgjithmonë të parashkruara dhe të pa ekzekutueshme.

Kështu, duke dështuar në një njoftim të tillë, e cila dëshmohet edhe me provat e bashkangjitura, ankuesi nuk është njoftuar dhe nuk ka pasur se si të njoftohet për likuidimin e NSH Ballkanik dhe rrjedhimisht afati për parashtrim të kërkesave nuk ka kaluar.

Me 18 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se qëndrimin e saj lidhur me argumentet e Ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmërisht i sqaruar në Mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktvendimin me nr.C-II.-20-0002-C0001 të DHPGJS, pranë shkallës së I-re. Përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtarë i propozon Kolegjit të Apelit që t'i referohet Mbrojtjes së aktvendimit përkatës.

AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS, është i saktë në rezultat andaj si i tillë duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi fillimisht me 29 janar 2020 në Shkallën e I-rë me padi ka kërkuar që atij ti njihen benificionet nga NSH IGK Ballakn" Suharekë, për periudhën kohore nga 20 shtator 1979 deri me 24 shtator 1990, meqë ishte punëtor i NSH-së në sektorin e shkrirjes së Gomës.

Me parashtresën e dt. 05 mars 2020, paditësi përmes një urgjence njoftoi DHPGJS se Agjencia Kosovare e Privatizimit i ka paguar shumën prej 20% nga privatizimi i Ndërmarrjes NSH "IGK Ballkani", ndërsa kërkoi nga DHP ti njoh borxhin e pa paguar sipas vendimit të NSH Ballkani nr.872, të datës 20 gusht 2001 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë të datës 24 qershor 2005.

Shkalla e I-rë me Aktvendimin C-II.-20-0002-C0001, të dt. 06 shtator 2022, e ka hedhë poshtë si të pa pranueshme ankesën kundër vendimit të AL, me arsyetimin se paditësi ka dështuar në përmbushjen e kërkesës sipas urdhrin të gjykatës për ta dorëzuar vendimin e kundërshtuar.

Kolegji i Apelit vëren se, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit dorëzoi në Dhomën e Posaçme njoftimin se likuidimi i NSH-së IGK Ballakn” Suharekë, kishte hyrë në fuqi me 06 mars 2008. Po ashtu AKM me dt. 25 mars 2008, kishte publikuar njoftimin ne gazetën Koha Ditore ku ishin informuara se likuidimi i ndërmarrjes në fjalë kishte filluara me 6 mars 2008 dhe se kishte informuar çdo person që beson se ka të drejte të praqes kërkesën e tyre kreditore deri me 31 maj 2008 tek Agjencia.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi parashtrroi padi në DHPGJS me dt. 29 janar 2020 kundër NSH-së, IGK Ballakn” Suharekë, ndaj të cilës ishte hapur procedura e likuidimit. Tutje Kolegji i Apelit vëren se dispozita e nenit 10 të Shtojcës së Ligjit të AKP- iu referohet vetëm lëndëve të cilat tanimë ishin parashtruar dhe ishin në pritje pranë Dhomës së Posaçme. Për lëndët e tilla procedura duhet të pezullohet pas paraqitjes së kërkesës nga Agjencia në bazë të nenit 10 të ligjit të përmendur më lartë. Sipas tij, pezullimi i padisë mund të bëhet vetëm për lëndët tanimë të dorëzuara dhe në pritje për tu zgjidhur.

Interpretimi i kësaj dispozite lidhur me likuidimin e një ndërmarrjeje duhet të kuptohet si një qëllim për t’ia mundësuar autoritetit të likuidimit që të zbatojë të njëjtat rregulla të përcaktuara me ligj në lidhje me secilën kërkesë të kreditorëve duke i zbatuar të njëjtat rregulla për të gjithë kreditorët. Kjo ndodh sepse vetëm autoriteti i likuidimit, si një organ i krijuar për likuidimin e ndërmarrjeve, e ka një pamje të qartë të aseteve dhe borxheve të ndërmarrjes. Në këtë kuptim, paditë tanimë të parashtruara në Dhomën e Posaçme duhet të pezullohen deri sa të merret një vendim përfundimtar nga Komisioni për Likuidim. Megjithatë, situata ndryshon nëse parashtrohet një ankese apo padi e re në Dhomën e Posaçme pasi që është bërë njoftimi nga ana e Agjencisë për likuidimin e një ndërmarrjeje. Në këtë rast, paditësi është dashur ta parashtrroj kërkesën e tij drejtpërdrejt tek komisioni për likuidim për realizimin e të drejtave të tij para se ta sjellë atë në Dhomën e Posaçme. Vetëm atëherë kur autoriteti i likuidimit vendos për kërkesën e paditësit dhe ky i fundit nëse nuk është i kënaqur me atë vendim, ai mund të parashtrroj kundërshtim në Dhomën e Posaçme duke e kundërshtuar vendimin e autoritetit të likuidimit.

Kolegji i Apelit po ashtu vlerëson se Likuidimi i NSH-së , IGK Ballakn” Suharekë ka filluar përpara se të bëhej padia e paditësit, dhe pasi që komisioni për likuidim nuk ka lëshuar vendim për kërkesën e kreditorit, padia e paditësit duhet të konsiderohet si e papranueshme.

Në rastet e tilla padia e paditësit e paraqitur në DHPGJS pas fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së, nuk duhet të pezullohet por duhet të hedhet poshtë si e pa pranueshme, andaj nga këto arsye ankesa e paditësit është refuzuar si e pa bazuar dhe është vërtetuar Aktvendimi i ankimuar i Shkalles I-rë.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 01 dhjetor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 mars 2024.

Mr.Sc, Sahit Sylejamani Gjyqtar kryesues
